

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7965
E premte, 10 janar 2025
Çmimi 0.50 €

Kurti: Byroja do të bëhet, secili do të tregojë sa ka pasuri **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE KA NJOFTUAR SE KA FILLUAR PERIUDHA E VOTIMIT PËRMES POSTËS PËR TË GJITHË SHITETASIT E KOSOVËS TË CILËT JANË REGJISTRUAR PËR TË VOTUAR NGA JASHTË KOSOVËS

MËRGATA E KOSOVËS FILLON VOTIMIN **FAQE 4-5**

- Gjermania me numrin më të lartë të votuesve jashtë Kosovës



Nga 6 janari e deri më 8 shkurt mbi 100 mijë shtetas të Kosovës që jetojnë jashtë vendit do të mund të votojnë me postë për zgjedhjet parlamentare të Kosovës më 9 shkurt.

Diaspora mund të votojë me postë ose në përfaqësitë diplomatike të Kosovës. Nga 104 924 votues që janë regjistruar për të votuar jashtë Kosovës, 84 525 prej tyre

kanë zgjedhur të votojnë përmes postës, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Gjermania është vendi me numrin më të lartë të votuesve jashtë Kosovës

PARALAJMËRIMI PËR BOJKOT TË DISA MEDIEVE NGA LV-JA SHIHET SI SULM NDAJ GAZETARËVE **F. 3**



SHTËPIA E BARDHË: SHBA-JA MBËSHKET NJË KOSOVË SOVRANE QË RESPEKTON KOMUNITETET PAKICË **F. 7**



OPINION

VOTIMI DO VËMENDJE TË VEÇANTË! **F. 6**

Hasan MUJAJ




AKTUALE



PARLAMENTI I LIBANIT E EMËRON PRESIDENT SHEFIN E USHTRISË **F. 2**

NDËRTOHET PROTOTIPI "VENTILATORI MEKANIK", UNIVERSITETI I PRISHTINËS NDIHMOM SHËNDETËSINË **F. 7**

EKONOMI



SAGA E "GRAND HOTEL"-IT, PSE DO TË PAGUAJË KOSOVA MILIONA PËR PRIVATIZIMIN E DËSHTUAR? **F. 8**

SPORT



KËTO JANË SHPËRBLIMET PËR FITUESIT NË SUPERLIGË DHE LIGËN UNIKE **F. 10**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Parlamenti i Libanit e emëron president shefin e ushtrisë

BEJRUT, 9 JANAR - Parlamenti i Libanit e ka emëruar të enjten shefin e ushtrisë së vendit, Joseph Aoun, si president. Libani kishte dy vjet pa president për shkak të ngërçit politik.

Votimi u zhvillua disa javë pas nisjes së një armëpushimi që i dha fund luftës mbi njëvjeçare në mes të Izraelit dhe grupit militant libanez, Hezbollah, dhe në një kohë kur liderët e Libanit po kërkojnë ndihmë ndërkombëtare për ta rindërtuar vendin.

Aoun shihej si kandidati i parapëlqyer i Shteteve të Bashkuara dhe Arabisë Saudite, mbështetjen e të cilave do t'i nevojitet Libanit për t'u rindërtuar.

Seanca e së enjtes ishte përpjekja e 13-të për ta zgjedhur pasuesin e Michel Aoun, mandati i të cilit mbaroi në tetor

2022.

Hezbollah e mbështeti fillimisht një kandidat tjetër, Suleiman Frangiegh, liderin e një partie të vogël të krishtere në veri të Libanit, e cila ka lidhje të ngushta me ish-presidentin e Sirisë, Bashar al-Assad. Megjithatë, të mërkurën, Frangiegh njoftoi se ishte tërhequr nga gara dhe e mbështeti Aounin, duke i hapur rrugën shefit të ushtrisë të zgjidhet president.

Hezbollahu, i cili e kontrollon Libanin jugor, është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Bashkimi Evropian e ka vendosur në listën e zezë krahun e tij të armatosur, por jo edhe partinë e tij politike. Randa Slim, hulumtuuese nga Instituti për Lindjen e Mesme me bazë në Uashington, tha se dobësimi i Hezbollahut politikisht dhe ushtarakisht në

luftën e tij me Izraelin dhe rënie e aleatit të tij, Assad, në Siri, së bashku me trysninë ndërkombëtare për të emëruar një president, kanë hapur rrugën për rezultatin e së enjtes. Sistemi i ndarjes së pushtetit në bazë sektare në Liban bën që të ketë shumë ngërçe për arsye politike dhe procedurale.

Roli i presidentit në Liban është i kufizuar për shkak të sistemit të ndarjes së pushtetit, sipas të cilit, presidenti është gjithmonë një i krishterë maronit, kryeministri mysliman suni dhe kryetari i Parlamentit shiit.

Megjithatë, vetëm presidenti e ka pushtetin për të emëruar ose shkarkuar kryeministrin dhe kabinetin. Qeveria kujdestare që ka udhëhequr Libanin gjatë dy vjetëve të fundit ka pasur kompetenca të kufizuara, pasi nuk ishte emëruar nga një president në detyrë.



Papa e kritikon Izraelin, e quan "të turpshme" situatën në Gazë

VATIKAN, 9 JANAR - Papa Françesku intensifikoi kritikën e tij ndaj fushatës ushtarake të Izraelit në Gazë, duke e quajtur situatën humanitare në enklavën palestineze si "shumë serioze dhe të turpshme".

Në adresimin vjetor para diplomatëve, që në emër të Papës e mbajti një nga këshilltarët, Françesku duket se iu referohej vdekjeve të shkaktuara nga i ftohti në Gazë, territor ku pothuajse nuk ka fare energji elektrike. "Ne nuk mund të pranojmë në asnjë mënyrë bombardimin e civilëve", u tha në fjalimin e Papës, që u lexua nga këshilltari i tij. "Ne nuk mund të pranojmë që fëmijët të ngrijnë për vdekje sepse spitalet janë shkatërruar apo se është



sulmuar rrjeti energjetik i vendit".

Papa pritej që personalisht ta mbante fjalimin, por i kërkoi një

këshilltari të tij që ta bënte në emër të tij, pasi Ati i Shenjtë është duke u rikuperuar nga një ftohje.

Fjalimi ishte pjesë e adresimit para emisarëve të akredituar në Vatikan nga afër 184 shtete. Ambasadori izraelit në Selinë e Shenjtë ishte i pranishëm në këtë ngjarje.

Françesku zakonisht është i kujdesshëm që të mos mbajë anë në konflikte. Por, së fundi, ai ka qenë më i zëshëm për fushatën ushtarake të Izraelit në Gazë dhe ka sugjeruar që komuniteti global duhet të hetojë nëse ofensiva përbën gjenocid ndaj popullit palestinez.

Në dhjetor një ministër izraelit publikisht e kishte kundërshtuar këtë sugjerim të Atit të Shenjtë. Lufta në Gazë nisi më 7 tetor 2023, pasi Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë

terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - sulmoi jugun e Izraelit duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë.

Fushata hakmarrëse ushtarake e Izraelit në Gazë ka lënë të vrarë më shumë se 46 000 palestinezë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në këtë territor. Kjo ministri ka thënë se mbi gjysma e viktimave ishin gra dhe fëmijë. Izraeli pretendon se ka vrarë më shumë se 17 000 militantë, por nuk ka dhënë prova për këtë pretendim. Izraeli ka shkatërruar pjesë të mëdha të territorit dhe lufta ka detyruar afër 90 për qind të popullsisë, prej 2.3 milionë banorësh, që të zhvendosen, shpesh disa herë.

Zjarret vazhdojnë të përhapen në Los Anxhelos

LOS ANXHELOS, 9 JANAR - Zjarret që kanë shpërthyer përreth Los Anxhelosit janë përhapur edhe në Hollivud Hills. Kjo fatkeqësi natyrore ka shkaktuar vdekjen e së paku pesë personave dhe shkatërrimin e qindra shtëpive. Më shumë se 100 000 persona janë urdhëruar që të evakuohen, përderisa erërat e fuqishme po pengojnë punën e zjarrfikësve për të shuar zjarret, por edhe po përhapin flakët. "Kjo stuhi zjarri është një e madhe", tha kryetarja e Los Anxhelosit, Karen Bass gjatë një konference për medie. Një vatër e re zjarri ka

shpërthyer në Hollivud Hills të mërkurën mbrëma, tha shefi i zjarrfikësve, Kristin Crowley, duke detyruar më shumë banorë që të evakuohen.

Në Los Anxhelos aktualisht janë të paktën gjashtë vatra aktive zjarri.

Katër nga to janë 0 % nën kontroll, thanë zyrtarët shtetërorë, përfshirë vatra të zjarrit në krahun lindor dhe atë perëndimor të qytetit që po vazhdojnë të digjen.

Departamenti i Zjarrfikësve në Los Anxhelos ka lëshuar urdhra për evakuimin e banorëve nga zona brenda Hollivud Boulevard

në jug, në Mulholland Drive në veri, në autostradën 101 në lindje e deri në Lauren Kanion Boulevard në perëndim.

Brenda kësaj zone gjendet Teatri Dobby, ku mbahet ceremonia e çmimeve Oscar. Nominimet për Oscar, që ishin paraparë për javën e ardhshme, janë shtyrë për dy ditë për shkak të zjarrit, thanë organizatorët.

Në pjesën perëndimore të Los Anxhelosit autoritetet thanë se janë djegur 6 406 hektarë dhe qindra struktura. Ndërkaq, në lindje janë djegur 4 289 hektarë, 1 000 struktura dhe janë vrarë të paktën pesë persona, thanë

zyrtarët.

Tre persona, po ashtu, janë arrestuar për plaçkitje, sipas policisë.

Dëmet e shkaktuara nga zjarri dhe humbjet në ekonomi vlerësohet të jenë miliarda dollarë. "Ne po përballemi me një fatkeqësi natyrore të përmasave historike", tha drejtori i menaxhimit të emergjencave në Los Anxhelos, Kevin McGowan.

Edhe pse parashikuesit e motit kanë paraparë që fuqia e erërave do të bjerë, kushtet e rrezikshme atmosferike pritet të vazhdojnë deri të premtën.



Pothuajse 300 000 shtëpi dhe biznese mbetën pa rrymë në Los Anxhelos të mërkurën, teksa shkollat janë të mbyllura. Përmasa e zjarreve ka bërë që zjarrfikësit të përballen me vështirësi dhe të punojnë përtej kapaciteteve të tyre. Zjarrfikës nga gjashtë shtete të tjera janë nisur drejt Kalifornisë për të ndihmuar në shuarjen e zjarreve.

Paralajmërimi për bojkot të disa medieve nga LV-ja shihet si sulm ndaj gazetarëve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 JANAR - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) është i shqetësuar me zhvillimet që lidhen me nisjen e fushatës për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Sipas AGK-së, paralajmërimi për bojkotimin e disa prej televizioneve kryesore në vend, si Klan Kosova, TV Dukagjini dhe T7, nga ana e partisë në pushtet, Vetëvendosje, është një zhvillim që shkon kundër transparencës dhe përpjekjeve për ta minuar rolin e gazetarëve dhe medieve për ta mbajtur përgjegjëse partinë që ka udhëhequr Kosovën për 4 vjet për politikën e saj. “E ftojme Lëvizjen Vetëvendosje që ta rishqyrtojë pozicionin e saj dhe t’u ofrojë medieve qasje të barabartë në fushatë. Medieve duhet t’u mundësohet që në mënyrë të barabartë t’i paraqesin programet e të gjitha subjekteve politike që garojnë, pasi puna e tyre është në interes të publikut. Bojkoti i paralajmëruar paraqet goditje të qëllimshme ndaj pluralitetit medial që e shquan Kosovën dhe është vazhdimësi e një sërë veprimesh të kësaj qeverie dhe të Lëvizjes Vetëvendosje të drejtuara kundër gazetarëve dhe medieve në Kosovë”, është thënë në reagimin e AGK-së. AGK-ja, gjithashtu, dënon targetimin e vazhdueshëm që zyrtarët e Vetëvendosjes bëjnë ndaj gazetarëve dhe medieve, duke përfshirë postimin e zëdhënësit Arlind Manxhuka, i cili, mes të tjerash, cilëson mediet edhe si “institucione



paralele”. “Kjo gjuhë e rrezikshme është e papranueshme dhe vështirëson klimën për ushtrimin e gazetarisë në Kosovë”, thuhet në reagimin e AGK-së. Shoqëria civile edhe më herët ka kritikuar qeverinë e Kosovës, të udhëhequr nga Albin Kurti për qasjen ndaj medieve. Flutura Kusari, këshilltare ligjore në Qendrën Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medias, tha për “Radion Evropa e Lirë” se bojkoti i medieve, në të cilat LV-ja ka qenë shpesh e pranishme sa ishte në opozitë në fushatën zgjedhore të vitit 2021, tregon se ky veprim po bëhet “për t’i ikur llogaridhënies dhe jo për

ndonjë arsye parimore”. “Bojkoti është vazhdimësi e luftës së Qeverisë dhe Lëvizjes Vetëvendosje kundër medieve, aktivistëve dhe shoqërisë civile të cilët përgjatë qeverisjes i ka konsideruar dhe trajtuar si armiq. Bojkoti është sulm ndaj medieve dhe të drejtës për informim dhe do të ishte mirë që Lëvizja ta rishqyronte këtë vendim”, tha Kusari. Sipas saj, sjellja e partisë në pushtet ndaj medieve është në kundërshtim me parimet e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, institucione ku Kosova synon të anëtarësohet. Duke folur për fushatën zgjedhore, Kusari tha se pret që të ketë “përshtetëzim të narrativit kundër medieve dhe

gazetarëve dhe shpresoj shumë që gjuha e ashpër ndaj gazetarëve të mos përkthehet në sulme fizike”. Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, e ka quajtur përpjekje të dëshpëruar për t’i kamufluar dështimet në qeverisje në katër vjet mandat, vendimin e pushtetit për t’i ikur ballafaqimeve me mediet. Sipas tij, nëse qeverisja aktuale do të kishte rezultate, zyrtarët e pushtetit “do t’i mbushnin studiot televizive”. “Ikja e partisë në pushtet nga debatet televizive e dalja në takime partiake nëpër komuna është përpjekje e dëshpëruar për t’i kamufluar dështimet në qeverisje në katër vjet mandat. Ndryshe nuk ka si të kuptohet.

Po të kishte rezultate, do t’i mbushnin studiot televizive e do të përballeshin me opozitën në çdo studio televizive, tryezë e forum. Është lehtë t’u flasësh militantëve partiakë që të duartrokin, por përballja me kundërshtarët politikë duhet bazuar në fakte. Katër vjet mandat: 12 miliardë euro buxhet e asnjë projekt i realizuar, asnjë investim madhor vendor apo i huaj, probleme me energji elektrike, asnjë njohje për shtetin e Kosovës, sanksione nga BE-ja, marrëdhënie të cenuara me aleatët kryesorë të Kosovës, afera në rezerva shtetërore, në energjetikë e në sektorë të tjerë”, ka shkruar Hoti në “Facebook”.

Vetëm gjatë vitit 2023 AGK-ja ka regjistruar 53 raste të sulmeve apo kërcënimeve ndaj gazetarëve. Po ashtu, vitin e kaluar në Indeksin për Lirinë e Shtypit të organizatës joqeveritare, Reporterët pa Kufij, Kosova u rendit në vendin e 75-të, apo 19 vende më poshtë se vitin paraprak. Në këtë raport u tha se, pavarësisht se vazhdojnë t’i mbajnë përgjegjës politikanët, gazetarët në Kosovë vazhdojnë të jenë “cak i sulmeve politike”. Ndërkaq, në raportin për të drejtat e njeriut të Departamentit Amerikan të Shtetit, vitin e kaluar, u citua Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës që tha se “zyrtarë të qeverisë, përfshirë kryeministrin dhe anëtarë të partisë në pushtet, janë angazhuar në fushata shpifëse për ta minuar besimin e publikut në medie”.

Trumpi komenton foton e Jack Smithit në Gjykatën Speciale: Ai është budalla, nuk duhet të lejohet të ekzekutojë njerëz

PRISHTINË, 9 JANAR - Presidenti i sapozgjedhur amerikan Donald Trump gjatë një fjalimi nga rezidenca e tij në Mar-a-Lago të martën shprehu kundërshtimin e tij ndaj asaj që ai e quajti “armatizim të drejtësisë” nga demokratët dhe kritikoi ashpër këshilltarin special amerikan, Jack Smith. Prokurori Jack Smith e sabotoi marrëveshjen e Shtëpisë së Bardhë në mes të Kosovës dhe Serbisë të negociuar nga administrata Trump, duke bërë publike një aktakuzë të pakonfirmuar ndaj presidentit Thaçi, një rast i paprecedent i ndërhyrjes së prokurorit Jack Smith në një proces politik. “Ata e sollën këtë budalla nga Haga. Ai është një djalë i keq. Ai është një djalosh i keq, i keq”, tha Trumpi. Presidenti Trumpi në këtë

konferencë për shtyp ka komentuar edhe fotografinë e Jack Smithit brenda Gjykatës Speciale, fotografi kjo e shkrepur kur po zhvillohej procesi gjyqësor ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi. Duke shikuar fotografinë e tij, presidenti Trump ka thënë se ai mund t’i ekzekutojë njerëzit dhe ai do t’i ekzekutojë të gjithë. “Fotografia e [Smithit] ishte perfekte, sepse ju shikoni foton e tij, thoni se është një djalë i keq me rrobën e tij - mantelin e tij të purpurt - dhe ai ekzekuton njerëz. Ai nuk duhet të lejohet të ekzekutojë njerëz, sepse ai do t’i ekzekutojë të gjithë. Ai është një punë e keqe”, tha presidenti Trump. Sipas mediumit “DailyMail”, kjo është fotografia të cilën e komentoi presidenti Trump. /Demokracia.com/





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE KA NJOFTUAR SE KA FILLUAR PERIUDHA E VOTIMIT PËRMES POSTËS PËR TË GJITHË SHTETASIT E KOSOVËS TË CILËT JANË REGJISTRUAR PËR TË VOTUAR NGA JASHTË KOSOVËS

Mërgata e Kosovës fillon votimin

- Gjermania me numrin më të lartë të votuesve jashtë Kosovës

Nga 6 janari e deri më 8 shkurt mbi 100 mijë shtetas të Kosovës që jetojnë jashtë vendit do të mund të votojnë me postë për zgjedhjet parlamentare të Kosovës më 9 shkurt. Diaspora mund të votojë me postë ose në përfaqësitë diplomatike të Kosovës. Nga 104 924 votues që janë regjistruar për të votuar jashtë Kosovës, 84 525 prej tyre kanë zgjedhur të votojnë përmes postës, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Gjermania është vendi me numrin më të lartë të votuesve jashtë Kosovës

PRISHTINË, 9 JANAR - Nga 6 janari e deri më 8 shkurt mbi 100 mijë shtetas të Kosovës që jetojnë jashtë vendit do të mund të votojnë me postë për zgjedhjet parlamentare të Kosovës më 9 shkurt, ndërsa më 8 shkurt ata do të mund të votojnë fizikisht në përfaqësi diplomatike të Kosovës në 22 vende të botës. Mënyra e votimit të tyre varet nga ajo se si ata kanë zgjedhur të votojnë kur janë regjistruar si votues. Nga 104 924 votues që janë regjistruar për të votuar jashtë Kosovës, 84 525 prej tyre kanë zgjedhur të votojnë përmes postës, sipas Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve (KQZ). Pra, 67 421 janë regjistruar për ta dërguar pakon me fletëvotim në kutinë postare të KQZ-së jashtë Kosovës, kurse 17 104 do ta dërgojnë pakon me fletëvotim në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë. Sipas regjistrimit të popullsisë, në diasporë jetojnë rreth 550 mijë kosovarë. Rreth 105 mijë qytetarë në diasporë janë regjistruar për të votuar në 9 shkurt në Kosovë. Mbi 44 mijë prej tyre jetojnë në Gjermani. Votimin do të mund ta bëjnë me postë nga 9 janari, ose në përfaqësitë diplomatike të

Kosovës vetëm më 8 shkurt. Mërgimtarët nga Kosova kanë mundësi të votojnë fizikisht më 8 shkurt në përfaqësi diplomatike dhe konsullore në vendet ku jetojnë. Vendvotimet në përfaqësi diplomatike dhe konsullore do të jenë të hapur prej orës 07:00 deri në orën 19:00, sipas kohës lokale në vendet përkatëse. Të drejtë vote kanë të gjitha ata që kanë dokumente identifikuese të lëshuara nga Kosova, si letërnjoftim, pasaportë ose lejen e vozitjes dhe që është regjistruar paraprakisht për votim. Në rast se dokumenti identifikues i lëshuar nga shteti i Kosovës është me afat të skaduar, atyre u kërkohet ta paraqesin edhe një dokument identifikues të vlefshëm të shtetit ku jetojnë, sipas KQZ-së.

Ku do të mund të votojë mërgata e Kosovës?

Qendrat e votimit në përfaqësi diplomatike të Kosovës për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që mbahen më 9 shkurt 2025, sipas Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve, janë në këto shtete: Australi, Austri, Belgjikë, Çeki, Danimarkë, Francë, Gjermani, Holandë, Hungari, Itali, Kanada, Kroaci, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Mbretëri të Bashkuar, Norvegji, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Shqipëri, Slloveni, Suedi, Turqi, Zvicër.

Një mërgimtar a mund të votojë në Kosovë ditën e zgjedhjeve?

Po. Një mërgimtar mund të vijë dhe të votojë në Kosovë në ditën e zgjedhjeve parlamentare më 9 shkurt. Ai mund ta bëjë këtë në vendvotimin e komunës së tij përkatëse. Por, për ta bërë këtë, ai nuk duhet të jetë i regjistruar paraprakisht si votues jashtë vendit. Votuesit e regjistruar jashtë vendit nuk e kanë emrin në listën e votuesve në Kosovë.

Më shumë rreth zgjedhjeve të 9 shkurtit

KQZ-ja ka bërë me dije se numri i votuesve për zgjedhjet e 9 shkurtit do të

jetë 2 milionë e 75 mijë e 868 votues brenda dhe jashtë Kosovës. Për këto zgjedhje janë certifikuar 28 subjekte politike me 1 280 kandidatë. Në fletëvotim, votuesit do të mund të zgjedhin një subjekt politik dhe deri në dhjetë kandidatë për deputetë. Ky është një ndryshim pas miratimit të Ligjit të ri për Zgjedhjet. Në të kaluarën qytetarët kanë pasur mundësinë të zgjedhin deri në pesë kandidatë.

Secila parti e certifikuar mund të ketë deri në 110 kandidatë në listën zgjedhore.

Nga këto lista do të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit me 120 ulëse dhe deputetët me pas zgjedhin qeverinë e re. Qeveria aktuale në Kosovë udhëhiqet nga Albin Kurti, kreu i Lëvizjes Vetëvendosje. Fushata zgjedhore do të nisë të shtunën, më 11 janar dhe për një muaj, partitë dhe kandidatët do të tentojnë t'i bindin votuesit që t'i zgjedhin ata. Këto do të jenë zgjedhjet e para të rregullta që Kosova mban që nga shpallja e pavarësisë më 2008.

A do të thotë mbyllja e institucioneve serbe edhe ndërprerje e punës së tyre? Jo

PRISHTINË, 9 JANAR - Punë edhe nga shtëpia, edhe nga një qytet kufitar i Serbisë. Ky është rasti i Milloshit nga veriu i Kosovës tash e disa muaj, pasi autoritetet e Kosovës e kanë mbyllur institucionin ku ai ka punuar, me arsyetimin se veprimtaria e tij, brenda sistemit të Serbisë, ka qenë e paligjshme. Një ose dy herë në javë Milloshi shkon për të punuar përtej kufirit, ku Beogradi zyrtar i ka zhvendosur institucionet e tij pas mbylljes.

Identiteti i vërtetë i tij, institucioni ku ai punon dhe vendbanimi i tij në Kosovë janë të njohur për "Radion Evropa e Lirë", por ai kërkon që të gjitha të mbeten anonime, nga frika se mund të akuzohet për "falsifikim dokumentesh" - ashtu siç e karakterizon, zakonisht, punën në institucionet serbe Prokuroria e Kosovës.

Në muajin dhjetor, "REL"-i ka përcjellë shkuarjen në punë të Milloshit dhe të disa qytetarëve të tjerë në një qytet kufitar të Serbisë. Ata nisen rreth orës 7:00 në mëngjes. Nganjëherë vonohen për shkak të tollovisë në trafik, por palët i presin me padurim para zyrave alternative, të vendosura në kontejnerë të zinj, pranë pikave kufitare: Bërnjak, Jarinjë e Merdar.

Disa kërkojnë certifikata ose dokumente të tjera

administrative, të lëshuara nga autoritetet serbe, e të tjerë dokumente për kredi në bankë, apo të ngjashme.

Gjatë tri-katër ditëve të tjera të punës në javë, Milloshi punon nga shtëpia në Kosovë. Në shtator të vitit të kaluar, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se nuk do t'i mbyllë institucionet për Kosovën dhe ka paralajmëruar hapjen e "zyrave moderne" në anën serbe të pikave kufitare. Ai ka premtuar edhe më shumë të ardhura për ata që udhëtojnë, në mënyrë që t'u mbulojnë shpenzimet. Por, ka edhe nga ata që nuk shkojnë në punë pas mbylljes së institucionit të tyre nga autoritetet e Kosovës. Petri nga Mitrovica e Veriut është një nga ta. Ai shkon në Rashkë të Serbisë vetëm për të marrë rrogën, meqë dinari serb është hequr nga përdorimi në Kosovë qysh në shkurt të vitit të kaluar. "Unë nuk shkoj në punë, por rroga më del në llogarinë në dinarë. Ndoshta edhe kjo është dashur të zgjidhet, në mënyrë që rroga të na dalë në euro", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Cilat institucione janë mbyllur deri më tani?

Autoritetet e Kosovës kanë vazhduar edhe këtë vit me mbylljen e institucioneve që

punojnë në sistemin e Serbisë e që Prishtina zyrtare i konsideron të paligjshme. Më 8 janar është mbyllur Administrata Tatimore në Mitrovicë të Veriut - njëherë nga katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës.

Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë, e cila ka mbështetjen e Beogradit - ka thënë se autoritetet kosovare i kanë mbyllur hapësirat e saj, por jo edhe Administratën Tatimore të Republikës së Serbisë që vepron në Kosovë.

Pas një takimi me rreth 80 punonjës të kësaj administrate, ajo ka thënë se ata do të vazhdojnë t'i marrin normalisht të gjitha përfitimet nga buxheti i Republikës së Serbisë.

Takime të ngjashme kjo parti ka mbajtur edhe me punëtorët e Drejtorisë për Urbanizëm, të Drejtorisë për Hapësira Banesore dhe Afariste dhe të Drejtorisë për Toka Ndërtimore në Mitrovicë të Veriut, të cilat janë mbyllur në fund të dhjetorit të vitit 2024.

Atyre u është premtuar se do të vazhdojnë të marrin paga dhe se do t'u ofrohet çdo lloj mbështetjeje.

Kosova ka nisur mbylljen e institucioneve serbe qysh në janar të vitit 2024, duke ua vënë fillimisht drynin organeve të përkohshme

komunale të Dragashit, Suharekës, Prizrenit dhe Rahovecit, të cilat gjendeshin në jug të lumit Ibër. Pastaj janë mbyllur organet e përkohshme komunale të Pejës, Istogut, Klinës, Skenderajt, si dhe ato në komunat në veri: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Ndërkohë janë mbyllur edhe degët e Postës së Serbisë në veri të Kosovës, kasaforta e Bankës Popullore të Serbisë në Leposaviq, Banka Kursimorja e Postës, Zyra për Kosovën e Qeverisë së Serbisë, Drejtoria e Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, Qarku Administrativ Kosovë-Mitrovicë dhe Qendra për Punë Sociale në Vushtrri.

Të gjitha këto institucione me mijëra punëtorë kanë funksionuar në sistemin e Serbisë.

Presidenti serb, Vuçiq, ka thënë në mes të shtatorit se mbyllja e tyre ka lënë rreth 5.800 persona pa punë, por se ata do të vazhdojnë t'i marrin pagat e tyre.

Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë e cilëson mbylljen e institucioneve serbe në Kosovë si "konfiskim të pronës serbe dhe okupim". "Radio Evropa e Lirë" ka pyetur këtë zyrë nëse ka ndonjë plan afatgjatë për institucionet që janë duke i mbyllur autoritetet e

Kosovës, por nuk ka marrë përgjigje.

Marrja e aseteve dhe ndërprerja e projekteve

Gjatë vitit të kaluar Agjencia Kosovare e Privatizimit ka përvetësuar edhe disa objekte në veri, duke thënë se ka juridiksion mbi to. Disa prej tyre ajo ua ka dhënë me qira biznesmenëve shqiptarë, të cilët kanë hapur dyqane ushqimore, restorante, pasticëri apo kafene, por popullata lokale serbe, kryesisht, i bojkoton ato.

Po ashtu, në fund të vitit 2023 Agjencia e Privatizimit ka marrë nën kontroll resorin "Rajska Banja" në Banjskë, afër Zveçanit, rinovimi dhe ndërtimi i të cilit janë iniciuar nga Qeveria e Serbisë, përmes Zyrës së saj për Kosovën, në vitin 2015.

Zyrtarët serbë kanë thënë se qeveria serbe ka investuar rreth shtatë milionë euro në këtë projekt.

Komuna e Zubin Potokut ka marrë nën kontroll edhe objekte banimi që janë ndërtuar me mjete të Qeverisë së Serbisë.

Në Mitrovicë të Veriut, ndërkohë, janë ndërprerë disa projekte të financuara nga Serbia - mes tyre, ndërtimi i një universiteti që do të funksiononte brenda sistemit serb.



Votimi do vëmendje të veçantë!



Hasan MUJAJ

Vendin parësor e persuasiv në konkurrencën zgjedhore duhet ta kenë temat që kanë të bëjnë me zhvillimin real ekonomik të shtetit, me sigurinë, me projektet që mund të realizohen që të ngrihet standardi i jetës së qytetarëve, që të hapen vende të reja të punës, sidomos për të rejtat dhe të rinjtë etj.

Së pari të bëhet vlerësimi i kandidatëve/ kandidatëve për deputetë, e pastaj votimi. Dy veprime të rëndësishme. Tejet të rëndësishme për shtetin. Për të gjithë qytetarët. Si rrjedhojë e këtyre veprimeve (e vlerësimit dhe votimit) do të formohen institucionet më të larta drejtuese të Kosovës. Pikërisht për këtë arsye, si kriter themeltar i votimit duhet të jetë aftësia e konkurrentëve për t'i përfaqësuar kërkesat e drejta të zgjedhësve si dhe përkushtimi për t'i kryer me përpikëri detyrat e tjera të deputetes/deputetit.

Retorika politike në Kosovë është në shkallë shumë të ulët sa u takon përbërësve të ndërtimit të saj. Po qe se ndiqen fjalimet politike të liderëve partiakë, të ministrave, të deputetëve etj. do të mund të vihet re mungesa e madhe, shumë e madhe e formimit retorik. Prandaj, mund të thuhet me të drejtë se ata (liderë, deputetë, ministra etj.) gabimisht kanë hyrë në politikë sepse nuk kanë përgatitje as teorike, as praktike nga retorika politike, as nga politolinguistika, as nga shkencat e tjera të komunikimit. Kanë hyrë në politikë jo se kanë themel përgatitjeje për të dhënë kontribut në këtë fushë të rëndësishme të veprimtarisë publike, porse kanë hyrë nga fakti për të arritur ndonjë përfitim material ose poste të larta politike.

Dituria nga retorika politike është mjeti kryesor i zhvillimit të veprimtarisë së oratorit pa të cilin (mjet) nuk mund të jetë efektiv në rolin e politikanit të suksesshëm. Pasi është kështu, pra, pasi shumë politikanëve u mungon ky mjet (kultura retorike), është plotësisht e qartë se nuk mund ta kryejnë si duhet obligimin ndaj qytetarëve, ndaj votuesve e ndaj institucioneve të shtetit sepse nuk dinë ta shprehin në fjalim, në diskutim, në debat, në intervistë e forma të tjera të komunikimit publik as atë që e mendojnë.

Nga ky këndvështrim s'është habi që politikanët e këtille, në njohuri retorike, ndjekin dy rrugë: 1. kush të përpiqet të flasë e të bjerë komik në publik nga deficit i retorik dhe 2. kush të heshtë, vetëm të dëgjojë sepse

detyrohet të jetë pasiv nga mungesa e forcës së fjalës dhe nga kufizimi i kulturës gjuhësore për ta shtënë atë (fjalën) në funksion tekstëzimi të komunikimit të fjalimit publik.

Në kohën antike, zyrtarëve të lartë të qyteteve/ shteteve, fjalimet e të cilëve nuk i plotësonin kriteret gjuhësore, sidomos në aspektin stilistik, u merrej e drejta e paraqitjeve me fjalimet zyrtare në foltoret publike.

Përkritazi me këtë ç'u tha më lart, mund të kuptohet shumë qartë edhe nga ky citat i prof. dr. Arshi Pipës, i cili, me shumë arsye, kishte shkruar: "Gjuha asht mjeti i shprehjes. Po të mos jetë mjeti i përsosun, asht e dijtun, vepra nuk del e mirë. Qysh mund të dali e bukur një shtatore kur dalta asht e paprehun." (Arshi Pipa, Kritika, Tiranë, 2006, f. 35). Me metafora të ekspresivitetit të lartë prof. Pipa shpreh rëndësinë dhe vlerën e madhe që ka gjuha (dalta) për të ndërtuar tekstin (shtatoren). Ky mendim i prof. A. Pipës është me vlerë të përhershme. Të mbahet parasysh, në kontekste të këtylla, edhe thënia e shkurtër e Sokratit nga ndërtimi, por e gjatë nga kuptimi: "Njihe veten!" Nga porosia e Pipës duhet të mësojnë të gjithë ata që nuk e zotërojnë mirë gjuhën standarde, nuk janë për foltore!

Deficiti i kulturës gjuhësore

Kjo mungesë është e pranishme të pjesa dërrmuese e zyrtarëve të lartë të shtetit. Mirëpo, për zyrtarët e lartë të këtij formati, të qenët pasivë në detyrën e besuar, nuk është shumë e rëndësishme. Relevante është për të zënë një pozitë të lartë të punës, paga e mirë dhe, a është kandidatja kompetente ose kandidati kompetent për atë vend pune, është irrelevant! Ironi e kohës. Filozofi gjerman Jurgen Habermas, ndër të tjera, tha: "Gjuha nuk është pronë private që, zyrtarisht, të përdoret si kush të dojë." Edhe Mark Tul Ciceroni, retor i me zulumë botërore, la porosinë me domethënie të gjithëkohshme në këtë aspekt: "Njeriu definohet nga gjuha që e flet."

Oratorët e kësaj kategorie nuk dinë të diskutojnë ngase qëndrojnë në deficit të madh sa i takon kulturës gjuhësore, prandaj, duke mos pasur leksik të mjaftueshëm fjalësh në ndërdije për të ndërtuar e modifikuar tekstin e fjalimit të mendimit politik, kalojnë në frazim në gërnja e fyerje, në sharje e madje edhe në sulme fizike ndaj njëri-tjetrit edhe përpara medieave pamore e të shkruara përmasash botërore, të cilat (sulme) krijojnë skena të neveritshme, degraduese e anarkike për shtetin, për partitë politike dhe për institucionet

shtetërore që i përfaqësojnë (p. sh. deputetët e Kuvendit të Kosovës) etj.

Autorët e fjalimeve dhe të diskutimeve, sidomos të natyrës politike, sikundër vihet re nga fjalimet e tyre, del e kuptueshme se nuk lexojnë literaturë përkatëse, nuk përgatiten për ta trupëzuar mendimin sipas kriterëve shkencorë të retorikës në të cilat (kriterë) vendin qendror e zënë: aspekti përbajtësor i temës dhe formulimi gjuhësor i ekspozimit të fjalimit etj. Paraqitjet e mendimeve të zyrtarëve të shtetit duhet të mbështeten edhe në dijen e politolinguistikës, e cila ka shumë kohë që është themeluar si shkencë e re dhe ndjek hulumtimin shkencor të zhvillimit të komunikimit politik në të dy format e shprehjes: gojore e shkrimore. Ajo (politolinguistika) është shkencë empirike e linguitikës aplikative; ajo integron përbërës të disiplinave shkencore të gjuhësisë dhe të dijeve të politikës. Zhvillimi i saj zuri fill e mori shtrirje të gjerë në vitet e 90-ta të shek. XX në hulumtimet e studimet e filologjisë gjermane në krye me studiuesin A. Burkhardt si analizë kritike e gjuhës politike dhe, nga dijetarët e shkencave të bashkërenduara, u kualifikua si shkencë e ndërlidhur - dyjare dhe u vu midis linguitikës e politologjisë. Studiuesi gjerman i shkencave të komunikimit, Armind Burkhardt, përkritazi me gjuhën e politikës, shkruan: "Jeta e politikanit është të flasë, të shkruajë dhe të lexojë." Aksiomë. Nuk është secila, secili për foltore. Kriteri i dijetarit gjerman nuk përfillet në Kosovë. Jo. Ky veprim u pa edhe nga listat e votimit për deputetë në të cilat u futën emrat e shumë deputetëve të deritashëm që, siç është parë nga veprimtaria e tyre e mëparshme si deputetë, nuk dinë të diskutojnë, sepse fjalori i tyre është shumë i ngushtë, i varfër, andaj është e kuptueshme se edhe performanca e fjalimit të tyre do të jetë e këtille nga mungesa e kompetencës.

Kandidatet e kandidatët e këtij niveli nuk do të duhej as të figurojnë në listat votuese, as të votohen. Megjithëkëtë, vihet re se liderët e partive politike nuk kanë qenë të kujdesshëm sa është dashur të jenë në përzgjedhjen e kandidatëve. Habi e madhe! Ata (liderët) dhe kryesitë e partive politike, nga listat e paraqitura të kandidatëve, mund të kuptohet sikur nuk janë të interesuar për të sjellë emra të rinj në listat zgjedhore, për të sjellë forca të reja krijuese e freskuese. Bënë risi shumë të vogël!

Nga ky këndvështrim mund të krijohet përshtypja se në ndonjë parti politike ende janë të pranishme gjurmët e partisë komuniste sipas të cilave lideri dhe kryesia kishin mandat të përhershëm!

Vite të tëra - deputetë!

Edhe kësaj here, në disa parti politike, u futën emra të njëjtë që me vite të tëra janë deputetë, mbase i kanë vendet e rezervuar! Veprim për qesëndi e dyshim!

Strukturat partiake, komunale e qendrore, gjatë fushatës zgjedhore, duhet të jenë shumë aktive në terren për t'iu folur qytetarëve për rëndësinë e zgjedhjeve dhe për pjesëmarrjen në votim në mënyrë masive, sidomos nëse e kërkojnë ndryshimin e qeverisjes së shtetit.

Aktivistët e partive politike duhet t'iu flasin votuesve për t'iu votuar më të mirët, për t'iu vlerësuar e analizuar kandidatët se cili ka përgatitjen e duhur për të dhënë kontributin më të çmuësëm në avancimin e proceseve të zhvillimit ekonomik, arsimor, kulturor, sportiv, politik etj. në favorin e përfortimit të institucioneve të shtetit të Kosovës.

KQZ-ja, tok me instanca të tjera, duhet ta shtrijë veprimin në forma të ndryshme edhe në terren për t'iu orientuar e mësuar votuesit edhe për anën teknike të votimit nga fakti se në zgjedhjet parlamentare të njëmbëdhjetë qershorit 2017 pati me njëjërë fletëvotime të pavlefshme.

Votimi është obligim ligjor, është obligim kushtetues, demokratik, etik dhe shtetëror. Ai është akt vendimtar për të formuar institucione legjitime që burojnë nga vullneti i lirë i qytetarëve për ta drejtuar dhe për ta zhvilluar shtetin me arritje të reja. Për këtë arsye, në shtetet më të zhvilluara dhe me demokraci të mirëfilltë, këtij procesi (votimit) i kushtohet vëmendje e posaçme nga institucionet përkatëse, por edhe nga qytetarët dhe zyrtarët kompetentë të vendit.

Vendin parësor e persuasiv në konkurrencën zgjedhore të shteteve me traditë të gjatë demokratike e zënë temat që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik të shtetit, me sigurinë, me projekte të realizueshme që të ngrihet standardi i jetës së qytetarëve, që të hapen vende të reja të punës etj.

Këto tema duhet ta kenë vendin e parë dhe më të rëndësishëm edhe në fushatën zgjedhore të Kosovës.

Por, në Kosovë, në fushatën parazgjedhore, sikundër mund të shihet nga praktika, vendin qendror në fjalimet e disa liderëve dhe të poltronëve të tyre nuk e kanë projektet me interes për jetën e qytetarëve, porse mbizotëron propaganda me premtimin shterpë, me akuzat dhe etiketimet për oponentët politikë, shpeshherë edhe me shpifje e trillime të ndryshme, me fjalimet panegjirikë që u referohen liderëve të partive politike edhe pse pa ndonjë meritë avancimesh të reja etj. Kjo veprimtari quhet demagogji.

Nga teoria në praktikë

Por, dështimet dhe shpërdorimet e mëdha të qeveritarëve nuk duhet t'i harrojnë qytetarët që po i pësojnë rrjedhojat stagnuese sa i përket zhvillimit ekonomik dhe varfërinë gjithnjë e më të madhe të jetës së tyre. Ekziston një shpërpjesëtim shumë i madh midis teorisë dhe praktikës në fjalimet e shtetarëve: ekonomia e Kosovës po përparon vetëm teorisht, por po vendnumëron praktikisht. Në shtetet me demokraci të zhvilluar dhe të stabilizuar, shpagimi i dukurive të këtylla antiligjore, sanksionohet edhe me votat e qytetarëve. Tani është koha që kështu të veprohet edhe në Kosovë.

Votimi nuk është veprim i lehtë. Ai kërkon njohje, meditim, analiza dhe vlerësim; ai kërkon angazhim të thukët për të gjitha shtresat e shoqërisë në mënyrë që të ngrihet kultura demokratike, e cila do të zhvillonte vetëdijen se duhet të çmohet dhe të votohet vlera dhe jo antivlera, të votohen flijimi e kontributi i asritëve të lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës, për shtetin sovran etj.

Shteti duhet të vihet mbi interesin privat të secilit. Ky është kriter i demokracisë, përfillja e të cilit nuk do të lejtonte që të vërshojnë shpërdorimet e ndryshme dhe veprimet anarkike; për këtë është më se i mbëhishëm edukimi demokratik që të mos gëjëni terren shtrirjeje dukuritë negative si: korrupsioni, nepotizmi, antivlera, interesi, përfitimi privat etj. Dhe, përdurisa nuk luftohen këto dukuri, është e kuptueshme që në institucionet e larta të shtetit do të emërohen njerëz të paafitë, se do të propozohen e do të votohen për deputetë njerëz që nuk dinë të flasin as të shkruajnë si duhet në gjuhën amtare madje kanë vështirësi të mëdha për ta gjuhëzuar mendimin, se lejohet e mundësohet të futen në politikë njerëz pa kapital elementar politik e retorik, se propozohen e votohen kandidatë për deputetë, të cilët nuk kanë njohuri elementare nga zhvillimet më të thjeshta të politikës së brendshme të shtetit, porse votohen për favore private etj.

Dhe, qytetari ynë i voton njerëzit e këtyllë sepse voton sipas sugjerimeve të të tjerëve, voton pa e ditur rëndësinë e votimit dhe pa e vlerësuar kandidatën; për ta votuar dikë, duhet ta vlerësosh lart të kaluarën dhe të sotmen e tij, biografinë dhe kontributin e deritashëm të tij etj. Vota duhet të jetë autonome, e lirë dhe pa ndërhyrje. Kjo është e drejtë ligjore. Kjo duhet t'u bëhet e qartë të gjithë qytetarëve. Fjalimet në fushatën zgjedhore duhet të karakterizohen nga retorika e përzgjedhur dhe korrekte, nga fjalori selektiv, kulturor, estetik dhe etik. Ato duhet të jenë në përpjesëtim me realitetin e të zbatueshme dhe jo premtime utopike.

Bordi i ZRrE-së takohet me ekipin e BERZh-it, flasin për zhvillimet e fundit në sektorin energjetik

PRISHTINË, 9 JANAR - Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji është takuar me ekipin e BERZh-it për të diskutuar rreth zhvillimeve kyçe në sektorin e energjisë. Sipas njoftimit, ndër temat kryesore ishte financimi nga BERZh-i i projekteve në rrjetin e transmissiionit dhe korniza ligjore për

përfshirjen e këtyre projekteve gjatë përshtatjeve vjetore nga ana e ZRrE-së. "Takimi, gjithashtu, u përqendrua në zhvillimet e fundit në sektorin energjetik, përfshirë gjendjen e rrjeteve të transmetimit, shpërndarjes dhe gjenerimit, hapjen e tregut të energjisë, zhvillimin e projekteve nga burimet e

ripërtërishme të energjisë përmes ankandëve, lansimi i tregut brenaditor dhe iniciativa e fundit për bashkimin e tregjeve, si dhe roli kyç i ZRrE-së në të gjitha këto procese", thuhet në njoftim. Më tej, ZRrE tha se mbetet e përkushtuar për fuqizimin e bashkëpunimit me

organizatat ndërkombëtare dhe të gjithë aktorët relevantë që në vazhdimësi kanë ofruar mbështetjen dhe ekspertizën e tyre për zhvillimin e sektorit të energjisë. "Bashkëpunime të tilla synojnë të sigurojnë furnizim të qëndrueshëm me energji për të gjithë konsumatorët dhe funksionimin e sektorit në



përputhje me direktivat evropiane", thuhet në njoftimin për medie.

Shtëpia e Bardhë: ShBA-ja mbështet një Kosovë sovraane që respekton komunitetet pakicë

WASHINGTON, 9 JANAR - Në një përmbledhje të politikës së jashtme amerikane gjatë katër viteve të fundit në udhëheqjen e presidentit Joe Biden, zëvendëskëshilltari për Sigurinë Kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, Jon Finer, tha të mërkurën se situata e sigurisë në Ballkanin Perëndimor mbetet "shqetësim i madh për Shtetet e Bashkuara". I ftuar për të diskutuar për çështje të ndryshme globale në institutin ndërkombëtar "Chatham House", me seli në Londër, Finer, i cili ka shërbyer në këtë pozitë të lartë në Shtëpinë e Bardhë, u pyet edhe për situatën në Ballkanin Perëndimor, ndikimin rus dhe



kinez në rajon dhe konfliktin e pazgjidhur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai tha se "ekzistojnë dy vija kryesore ndarëse për të

cilat jemi më të shqetësuar se për të tjerat" në Ballkanin Perëndimor, ndërkohë që theksoi se presidenti Biden

mbetet i përkushtuar në çështjet e sigurisë të këtij rajoni që nga koha kur kryesonte Komisionin e Senatit për Marrëdhënie me Jashtë. "Njëra është situata në Kosovë, një aleat thelbësor i Shteteve të Bashkuara, që është në tëhun e thikës", deklaroi Finer. Finer tha se sa i përket Kosovës është qëndrim amerikan që ajo "duhet të jetë edhe sovraane dhe t'i respektojë komunitetet pakicë të cilat ekzistojnë përbrenda asaj që është një Kosovë sovraane". Finer theksoi se këto janë çështje që administrata e presidentit Biden është angazhuar "t'i menaxhojë, shpesh nën radar

përmes diplomacisë së kujdeshme përgjatë tërë (mandatit) të kësaj administrate" dhe se ato mbesin sfida të cilat duhen vëzhguar dhe ku situata vazhdon të jetë shqetësuese. Ai tha se shqetësim tjetër për ShBA-në në këtë rajon "është ndarja e mundshme" e Bosnjës, "ku të paktën njëri nga udhëheqësit, Dodik, të paktën në formë retorike po ndjek një agjendë që bën thirrje për shpërbërjen e shtetit, të cilin ne e kundërshtojmë fuqishëm". Ai tha se Shtetet e Bashkuara besojnë që "nuk ka qasje më të mirë se (Marrëveshja) e Dejtonit për ta ruajtur paqen në Bosnjë".

Kurti: Byroja do të bëhet, secili do të tregojë sa ka pasuri

MITROVICE, 9 JANAR - Në një tubim të mbajtur në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica" në Mitrovicë, kryeministri Albin Kurti u drejtoi një mesazh mërgimtarëve që nuk kanë arritur të regjistrohen për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025. "Ata të cilët nuk janë regjistruar u mbetet metoda e vjetër: me aeroplan, autobus ose veturë", tha Kurti gjatë fjalimit të tij. Në këtë tubim kryeministri përmendi disa nga arritjet e qeverisë së tij gjatë vitit 2024. Kurti theksoi se rritja ekonomike e vendit është arritur pa borxhe të reja. "Përkundrazi, e kemi zvogëluar", tha ai. Duke folur për prioritetet e mandatit të ardhshëm, kryeministri nënvizoi rëndësinë e reformimit të sistemit të drejtësisë dhe miratimit të Byrosë për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme. "Të dashur mitrovicas, deri tash



e kanë shty, nuk munden ma. Do të bëhet Byroja. Secili do të tregojë sa ka pasuri. Nuk kemi kurrë kundër njerëzve të pasur, veç duhet me na kallëzu kah i kanë marrë paratë", tha Kurti, duke shtuar se reforma e Këshillit Prokurorial të Kosovës është e domosdoshme. Projektligji për Byronë për konfiskimin e pasurisë së pajustificuar u miratua nga Kuvendi më 5 dhjetor 2024, por është dërguar në Gjykatën

Kushtetuese nga PDK më 13 dhjetor 2024, së bashku me 12 projektligje të tjera. Kryeministri foli edhe për situatën në veri të vendit, duke theksuar se atje tashmë janë shtrirë ligjshmëria dhe kushtetutshmëria. Ai përmendi sulmet terroriste në Banjskë dhe kanalit e ujit të "Ibër-Lepencit", duke i cilësuar si aksione të dështuara. "Ata sa herë të provojnë do të dështojnë", tha Kurti.

Ndërtohet prototipi 'Ventilatori Mekanik', Universiteti i Prishtinës ndihmon shëndetësinë

PRISHTINË, 9 JANAR - Një prototip i ventilatorit mekanik, pajisje mjekësore që ndihmon frymëmarrjen duke dërguar ajër në mushkri dhe nxjerrë prej tyre dyoksidin e karbonit, është krijuar në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës. Prototipi i ventilatorit është realizuar nga studenti i diplomuar në studimet master të Departamentit të Mekatronikës të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës, Petrit Abdyli dhe profesori i këtij fakulteti, Arbnor Pajaziti. Ventilatori unik, i krijuar në laboratorët e FIM-it, është vazhdim i punës së studentit Abdyli dhe temë e diplomës së tij që lidhej pikërisht me programimin dhe lidhjen e sensorëve dhe aktuatorëve në



prototipin e ventilatorit mekanik. Kjo pajisje, shumë e rëndësishme gjatë intervenimeve kirurgjike dhe për personat me frymëmarrje të vështirësuar, bën lidhjen mes fushës së mekatronikës dhe mjekësisë dhe tregon se Universiteti i Prishtinës dhe njësitë akademike të tij janë në hap me zhvillimet teknologjike të kohës dhe inovacionin. Projekti i financiar nga BE-ja dhe Rektori i Universitetit të Prishtinës nisi si ide në kohën e virusit Covid 2019 kur mësimi mbahej online dhe kishte shumë nevojë për pajisje të tilla.

Mesazhi i fortë amerikan i janarit 2025!

PRISHTINË, 9 JANAR - Ish-kryeinspektori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), njohësi i sigurisë, Burim Ramadani, ka thënë se goditjet eventuale amerikane të individualizuara në Ballkanin Perëndimor janë zgjeruar në aspektin ligjor para ardhjes në detyrë të presidentit të ri atje.

"Mesazhi amerikan i zgjerimit të bazës ligjore për 'Listat e Zeza' në Ballkan, përmes plotësimit të Urdhrit Ekzekutiv të presidentit Joe Biden, është mesazh shumë direkt për një masë njerëzish anekënd rajonit. Shpresoj që kjo të përfshijë, ndër të tjera, të gjithë të ndërlidhurit me Qendrën Ruse të Spiunazhit në

Nish të Serbisë. Përpos bazës paraprake ligjore, tashmë ngjarjet në Ballkanin Perëndimor që mund të ndëshkohet janë edhe ato që përfshijnë përpjekjet e vazhdueshme të individëve: për ta sfiduar sovranitetin dhe integritetin territorial të vendeve të Ballkanit

Perëndimor, për t'i minuar marrëveshjet dhe institucionet e pasluftës, për t'u përfshirë në korrupsion të konsiderueshëm që gërryen sundimin e ligjit dhe besimin në qeverisjen demokratike, dhe për t'u shmangur sanksioneve të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.



Saga e “Grand Hotel”-it, pse do të paguajë Kosova miliona për privatizimin e dështuar?



PRISHTINË, 9 JANAR - Gati 20 vjet pas tentativës së dështuar për privatizimin e “Grand Hotel”-it në Prishtinë, shteti i Kosovës do t’i paguajë mbi 7 milionë euro kompanisë “Mabco Construction”, që fitoi gjyqin në arbitrazhin ndërkombëtar në fillim të janarit.

Kjo kompani, në pronësi të Behgjet Pacollit, deputet dhe ish-president i Kosovës, pretendon se i është bërë padrejtësi, pasi ka paguar për aksione të hotelit që nuk i mori kurrë. Ministria e Drejtësisë e Kosovës ka pranuar se do të duhet ta kryejë këtë pagesë, por ka theksuar se “Grandi do të mbetet në pronësi të Kosovës”.

Një recepsion i gjerë, me dollapë të vegjël që mbajnë çelësat e dhomave, është pamja e parë që të shfaqet në hyrje të “Grand Hotel”-it në Prishtinë. Megjithatë, pritja e mysafirëve nuk është aktualisht aktiviteti më i zakonshëm në këtë objekt, që është në pronësi publike.

Së voni, në të djathtë të recepsionit, shpesh shihen fleta të bardha me mbiemra familjesh dhe shigjeta orientuese, që drejtojnë për në salla ku organizohen pritje ngushëllimesh në raste vdekjesh. Kjo është një nga mënyrat sesi po përdoren sallat e hotelit sot, i cili në vitet '70 kishte namin si një nga hotelet më të mëdha në ish-Jugosllavi. Në Grand janë vendosur disa biznese dhe organizata

joqeveritare të cilat operojnë në hapësirat e këtij objekti me një sipërfaqe prej rreth 32 000 metrash katrorë.

I ndërtuar në vitin 1978, hoteli ka gjithsej 350 dhoma por, sipas deklarimeve të fundit në medie të menaxhmentit, aktualisht janë funksionale vetëm rreth 150 prej tyre, me pagesë prej rreth 20 eurosh në natë. Prania e tij online është pothuajse inekzistente, përfshirë në platformat ndërkombëtare për udhëtime si Booking, ndërsa uebfaqja zyrtare e hotelit nuk funksionon.

Si nisi dhe pse dështoi privatizimi i hotelit?

Që nga ndërtimi “Grand Hotel”-i ishte pronë shoqërore, i destinuar për akomodim dhe gastronomi. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe luftës në Kosovë më 1999, Grandi kaloi në pronësi të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). Kjo agjenci, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, u shndërrua në atë që sot quhet Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), e cila merret me privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore.

Në vitin 2005 asokohe AKM-ja nisi procesin e privatizimit të “Grand Hotel”-it përmes një metode të njohur si “Spin Off Special”, sipas së cilës, blerësi nuk kishte të drejtë ta

ndryshonte funksionin e ndërmarrjes.

Në vitin 2006, pas përfundimit të procedurave të ofertimit, fitues u shpall Zelqif Berisha, pronar i kompanisë “Unio Commerce”. Sipas kontratës, Berisha do të paguante mbi 8 milionë euro në këmbim të aksioneve të “Grand”-it. Kontrata parashihte që blerësi i “Grand”-it të investonte rreth 20 milionë euro brenda dy vjetësh dhe të punësonte më shumë se 400 punëtorë.

Pas konstatimit se investimet e parapara nuk ishin realizuar, më 2012, institucioni që tashmë njihet si AKP, vendosi t’i rikthente aksionet e Grandit, duke ia hequr pronësinë Berishës.

Ndonëse ishte ankuar në shumë instanca gjyqësore, deri në Gjykatën Kushtetuese, Zelqif Berisha nuk arriti kurrë t’i rikthente aksionet e Grandit. “Radio Evropa e Lirë” ka provuar të marrë komente nga Berisha në lidhje me këtë çështje, por ai nuk ishte i qasshëm deri në çastin e publikimit të këtij artikulli.

Si u përfshi në këtë histori kompania e Behgjet Pacollit?

Në gjithë procedurën për blerjen e “Grand”-it, Zelqif Berisha dhe kompania e tij figuronin zyrtarisht si blerësit e vetëm. Megjithatë, në atë kohë, pretendentë për

aksionet e “Grand”-it u bënë edhe kompania e Behgjet Pacollit,

“Mabco Construction”, e regjistruar në Zvicër, si dhe biznesmeni tjetër nga Kosova, Remzi Ejupi, me kompaninë e tij “Eurokoha Reisen”.

Këta të dy, sipas deklarimeve publike dhe proceseve të mëvonshme gjyqësore, pretenduan se kishin arritur një marrëveshje me Berishën për ta bashkëfinancuar blerjen e “Grand”-it.

Sipas kësaj marrëveshjeje, Berisha do të mbante 40 % të aksioneve, ndërsa “Mabco” do të fitonte 40 % të tyre dhe 20 % të tjera do t’i takonin “Eurokohës”.

“Mabco” pretendoi se për blerjen e “Grand”-it kishte bërë një transferim prej 4 milionë eurosh, para që u inkasuan nga AKP-ja.

Megjithatë, bashkëpronësia e kompanive të tjera nuk u njoh kurrë nga AKP-ja dhe nuk u zyrtarizua gjatë procesit, pavarësisht se dy kompanitë e tjera ndoqën çështjen ligjrisht në shumë instanca gjyqësore.

Përfaqësuesit e Zelqif Berishës kanë thënë se kompania e tij ka bërë investime në “Grand”.

Çështja mbeti pezull deri në vitin 2017, kur “Mabco Construction” paraqiti një ankesë në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve (ICSID), një gjykatë ndërkombëtare arbitrazhi në Uashington, duke kërkuar që

kompanisë t’i ktheheshin paratë e paguara. Në këtë gjykatë, “Mabco” u përball me Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës, e cila e përfaqësoi shtetin në këtë procedurë.

Më 4 janar Pacolli njoftoi përmes një postimi në “Facebook” se gjykata kishte vendosur në favor të kompanisë së tij. “Vendimi i arbitrazhit ndërkombëtar është një obligim për qeverinë që ta kthejë shumën që ‘Mabco’ e pagoi në vitin 2006 në llogarinë e shtetit”, shkroi Pacolli.

Ndonëse nuk e kanë publikuar vendimin, në faqen e ICSID-it figuron se vendimi për rastin e “Mabco”-s kundër shtetit të Kosovës është marrë më 3 janar. Këtë vendim e ka konfirmuar, po në “Facebook”, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e cila pranoi se detyrohen ta bëjnë pagesën për “Mabco”-n, por se kompania nuk do të marrë aksione të “Grand”-it. “Pronësinë mbi pronën publike nuk ia lejojmë askujt. Prandaj, ‘Grand’-i mbetet i Kosovës e i qytetarëve të saj”, shkroi ajo më 4 janar.

Sa do të paguajë qeveria dhe kur?

Sipas avokatit të “Mabco”-s, Shkumbin Asllani, shuma që shteti i Kosovës i detyrohet kompanisë është rreth 7 milionë euro. Ai shpjegon se kjo shumë përfshin 4 milionë eurot e paguara nga “Mabco” në vitin 2006 si dhe interesin e vlerësuar dhe shpenzimet procedurale.

Gjithashtu, sipas tij, vendimi është i ekzekutueshëm menjëherë. “Qeveria e Kosovës ka 60 ditë për ta ekzekutuar pagesën. Nëse nuk e bën, fillon rrjedhja e interesit, pas publikimit të vendimit, që nënkupton se shumë prej 7 milionë i shtohet interes shtesë”, thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas Asllanit, Remzi Ejupi dhe kompania e tij nuk ishin palë në këtë proces, të cilin kompania “Mabco” e ndoqi si e vetme.

Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Drejtësisë, nuk u është përgjigjur pyetjeve të “REL”-it në lidhje me shumën që duhet të paguhet apo nëse vendimi është i apeluar.

As Remzi Ejupi nuk ishte i qasshëm për të dhënë një koment në lidhje me rastin.

Deri më tani Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Qeveria e Kosovës nuk kanë dhënë përgjigje lidhur me planet konkrete për hotelin në të ardhmen.

Emisari i zgjedhur për Ukrainën: Trump dëshiron një përfundim të drejtë të luftës

I zgjedhuri nga Donald Trump për postin e të dërguarit për Ukrainën dhe Rusinë, tha se presidenti i zgjedhur amerikan do të ketë parasysh interesat e Kievit kur ai të nisë punën për arritjen e një marrëveshjeje për dhënien fund të luftës dhe do të synojë që zgjidhja të jetë e drejtë.

“Njerëzit kanë nevojë ta kuptojë se ai nuk po tenton t’i japë diçka presidentit rus, Vladimir Putin apo rusëve”, tha Keith Kellogg, gjenerallejtënant në pension, të cilin Trumpi e ka zgjedhur në postin e të dërguarit të tij për Ukrainën dhe Rusinë dhe e ka ngarkuar me udhëheqjen e negociatave për t’i dhënë fund luftës.

“Ai po tenton të shpëtojë Ukrainën dhe të shpëtojë sovranitetin e saj”, tha Kellogg gjatë një interviste për Fox News më 8 janar. “Ai do të sigurohet që të jetë i drejtë dhe këtë e ka thënë vazhdimisht”, përfshirë edhe presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky. Trump gjatë fushatës presidenciale vitin e kaluar tha se ai do t’i jepte fund konfliktit në Ukrainë brenda 24 orësh pasi të merrte detyrën e presidentit. Tani ai shpreson që t’u japë fund luftimeve brenda gjashtë muajve.

“Shpresoj që të ndodhë para se të kalojnë gjashtë muaj”, tha Trump gjatë një konference për



media më 7 janar kur u pyet nëse do të mund të zgjidhte konfliktin për gjysmë viti. Kellogg tha se ai preferon një

periudhë më të shkurtër kohore, në një periudhë prej 100 ditësh nga inaugurimi i Trumpit si presidenti më 20

janar. Sipas emisarit, ai dhe Trumpi dëshirojnë që t’i japin fund luftës sa më shpejt të jetë e mundur.

Kellogg nuk pranoi të zbulonte përmbajtjen e ndonjë nga bisedat e tij me Trumpin mbi luftën, duke thënë se Trump “flet vetë” dhe më shumë informacione për këtë temë do të bëhen publike pas inaugurimit.

Ai la të kuptohet se po punohet që Trump dhe Putin të bisedojnë.

“Ne do të vendosim kushtet... dhe ai më pas do të jetë në pozitë që të bisedojë me Putinin dhe po ashtu me presidentin Zelensky dhe mendoj se do të arrijmë deri te një zgjidhje në një periudhë të shkurtër kohore”, tha Kellogg.

Megjithatë, ai nuk u pyet lidhur me shtyrjen e një vizite që ai pritej të zhvillonte gjatë këtij muaji në Kiev dhe në kryeqytete të tjera evropiane. Ministri i Jashtëm ukrainas, Andriy Sybiha, njoftoi më 7 janar se kjo vizitë do të riplanifikohet.

Gjatë intervistës, Kellogg kritikoi presidentin amerikan, Joe Biden, për moskomunikim me Putinin, duke thënë se kanë kaluar më shumë se dy vjet që kur ata kanë biseduar. Trump, në anën tjetër, flet si me kundërshtarët ashtu edhe me aleatët, tha ai.

“Ai e di se duhet të flitet me njerëz për të arritur te një zgjidhje përfundimtare dhe kjo është ajo çfarë ne do të bëjmë”, tha Kellogg./REL

Rrëzimi i avionit me 38 të vdekur në Kazakistan, Rusia reagon sërish për akuzat e Azerbajxhanit

Kremlini refuzoi sërish të pranojë përgjegjësinë për rrëzimin e muajit të kaluar të një avioni të Azerbajxhanit Airlines, ku humbën jetën 38 persona, pavarësisht këmbënguljes së Bakut se avioni u godit nga zjarri rus. Moskë as nuk e ka mohuar dhe as ka konfirmuar këtë

version të ngjarjes, duke nxitur zemërimin e Azerbajxhanit, një vend i Kaukazit që është aleat i Rusisë.

I pyetur sot në lidhje me akuzat e Azerbajxhanit, zëdhënësi presidencial rus Dmitry Peskov u përpoq të shmangte ngjarjen, duke

thënë vetëm se ai shpresonte për një “hetim objektiv dhe të paanshëm”.

“Ne jemi të interesuar për një hetim tërësisht objektiv dhe të paanshëm për të gjetur shkaqet e kësaj fatkeqësie. Ju siguroj që ekspertët rusë po ofrojnë ndihmën e nevojshme në hetim,” tha Peskov.



Meloni: Gjykata e Kasacionit na dha të drejtë, qendrat e emigrantëve në Shqipëri janë gati




Gjykata e Kasacionit na dha të drejtë, ndërkohë që qendrat e emigrantëve në Shqipëri janë gati, deklaroi sot kryeministrja italiane, Giorgia Meloni, në konferencën vjetore të shtypit me gazetarët.

“Më duket se vendimet e Gjykatës së Kasacionit i japin të drejtë qeverisë, pasi thonë se i takon qeverisë të krijojë vende

të sigurta. Qendrat në Shqipëri janë gati për të funksionuar. Vitin e kaluar zbakimet u ulën me 60%, vitet e fundit pothuajse janë zhdukur, por për sa na përket neve qendrat janë gati për të qenë operacionale”, theksoi Meloni. Duke folur për vendimin e Gjykatës së Kasacionit, Meloni argumentoi se gjyqtari nuk

mund të mos zbatojë sistematikisht ndalimin e emigrantëve që vijnë nga ato vende, por mund të motivojë çështje specifike.

“Kjo është diçka krejtësisht e ndryshme nga ajo që bëjnë magistratët e gjykatës së Romës, që nuk duhet hyjnë në çështjet individuale”, tha Meloni.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Këto janë shpërblimet për fituesit në Superligë dhe Ligën Unike

“Epoka e re”

PRISHTINË, 9 JANAR - Pjesa vendimtare e garave në Kosovë ka filluar. Shumë skuadra janë në garë për trofetë e çmuar. Shpërblimet do të jenë të njëjta si te meshkujt ashtu edhe te femrat. Fituesit e Kupave të Kosovës do të shpërblehen me nga 10 mijë euro. Kjo është e njëjtë si te meshkujt ashtu edhe te femrat. Shuma të njëjta për fituesit janë edhe në ProCredit Superligën e Kosovës dhe Superliga Femrat. Shuma totale është 24 mijë euro në të dyja konkurrencat. Kampioni do të fitojë 12 mijë euro, gjashtë mijë do të jenë për finalistin dhe nga tre mijë euro për gjysmëfinalistët e “play-off”-it. Federata e Basketbollit të Kosovës ka njoftuar se në Kupën e Kosovës, fituesi do të shpërblehet me 10 mijë euro te meshkujt dhe po aq te femrat, kurse në Superligë me 24 mijë euro total shpërblimi. Në Superligën e Femrave: 12 mijë kampioni, 6 mijë nënkampioni, 3 mijë



gjysmëfinalistët e “play-off”-it, 3 mijë gjysmëfinalistët e “play-off”-it. Ndërsa në ProCredit Superliga: 12 mijë kampioni, 6 mijë nënkampioni, 3 mijë gjysmëfinalistët e “play-off”-it, 3 mijë gjysmëfinalistët e “play-off”-it. Ndërsa Liga Unike po vazhdon me edicionin 2024-25 në të dyja konkurrencat. Kjo garë zhvillohet në mes të skuadrave nga Kosova dhe atyre nga Shqipëria. Tetë skuadra garojnë te meshkujt

për trofeun e çmuar dhe gjashtë te femrat. Shpërblimet do të jenë të barabarta si te meshkujt ashtu edhe te femrat. Kampioni do të fitojë gjashtë mijë euro, finalistët tre mijë euro, derisa gjysmëfinalistët nga 1 500 euro. Liga Unike Femrat: 6 mijë euro për kampionin, 3 mijë finalistët dhe 1 500 gjysmëfinalistët. Në Liga Unike Meshkujt: 6 mijë euro shpërblehet kampioni, 3 mijë finalistët dhe 1 500 gjysmëfinalistët.

Drenica pas Jasharit transferon edhe Gashin

SKENDERAJ, 9 JANAR - FC Drenica, që bën gara në Ligën e Parë të Kosovës në futboll, ka vazhduar përforcimet. Një ditë pasi e paraqiti Iball Jasharin nga Prishtina, skuadra kuqezë e ka paraqitur sulmuesin Armend Gashi. Sulmuesi këmbëshpejtë Armend Gashi ka luajtur më parë për skuadrat si Prishtina, Trepça '89 dhe, së fundmi, pjesë e Feronikelit, ku pati 13 paraqitje gjatë stinorit vjeshtor. “Gashi ka arritur marrëveshje me klubin deri në fund të këtij edicioni me mundësi vazhdimi dhe tashmë ka nisur stërvitjet me skuadrën dhe kësaj është vënë nën urdhrat e trajnerit Arsim Thaqi. Gashi me cilësitë e tij do t'i ndihmojë skuadrës në pranverë për arritjen e objektivit, Superligën!”, thuhet në njoftimin e Drenicës që synim kryesor e ka rikthimin në Superligë.



SHKURT

Osmani: Podujeva po bëhet qyteti i parë në Kosovë me pishinë gjysmolimpike publike

Zëvendësministrja e Sportit, Daulina Osmani, ka thënë se Podujeva po bëhet qyteti i parë në Kosovë me pishinë gjysmolimpike publike. “Në bashkëbisedim me sportistët dhe artistët e Llapit! Podujeva po bëhet qyteti i parë në Kosovë me pishinë gjysmolimpike publike, ndërsa qendra multifunkionale që është në ndërtim do të shndërrohet në një bazë për aktivitete rinore dhe artistike të qytetit”, ka shkruar Osmani në “Facebook”. E dyta në ministrinë e Sportit ka bërë me dije se Liqeni i Batllavës do t'i mirëpresë sportet në ujore të Lojërave Mesdhetare. “Në Lojërat Mesdhetare 2030 liqeni i Batllavës do t'i mirëpresë sportet ujore, duke sjell investime që do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe turistik të zonës”, ka shtuar Osmani.

Flamur Neziri i bashkohet Prishtinës

Ish-portieri i mirënjohur Flamur Neziri i është bashkuar skuadrës së Prishtinës. Neziri ishte portier aktiv i 2 Korrikut, njëkohësisht ushtrues i rolit të trajnerëve të portierëve, kurse ka vendosur t'i bashkohet skuadrës që për një kohë të gjatë zhvilloi karrierën si futbollist. “Ish-portieri i mirënjohur i skuadrës sonë, së fundi portieri aktiv i 2 Korrikut, njëkohësisht ushtrues i rolit të trajnerëve të portierëve, tani e tutje do të jetë pjesë e skuadrës sonë. ‘Muli’, duke qenë pjesë e Shkollës së Futbollit FC Prishtina, në cilësinë e trajnerit të portierëve, të më të rinjve, nga ‘duart e arta’, do të provojnë t'i realizojnë ëndrrat e tyre drejt ngjitjes së majave në mes të shtyllave”, thuhet në njoftimin e Prishtinës. Neziri me FC Prishtina në tre edicione (2010-2013) me klubin tonë ka regjistruar 84 paraqitje dhe katër trofe të fituar, dy tituj kampioni, një Kupë dhe një Superkupë të Republikës.

Napoli synon transferimin e Zhegrovës

Napoli e ka bërë prioritet afrimin e sulmuesit Edon Zhegrova nga Lille në afatin e janarit. Gazetari Fabrizio Romano raporton se ylli i Kosovës është kontaktuar nga skuadra italiane, ku gjendet edhe Amir Rrahmani, megjithatë Lille po e vështirëson situatën. Sipas tij, Lille nuk dëshiron ta shesë Zhegrovën kësaj nuk po ia hap derën largimit të mundshëm të janarit. “Napoli e ka kontaktuar edhe Lillen këtë javë për Edon Zhegrovën, i cili është lart në listën e tyre. Napoli e vlerëson Zhegrovën, por Lille nuk ia ka hapur derën një largimi të janarit deri më tani, nuk po e bën të lehtë sepse nuk dëshiron ta mbajë”, ka shkruar ai. Zhegrova këtë sezon po vazhdon të kalojë një formë fantastike te klubi francez, ku ka regjistruar 17 paraqitje në Ligën 1 dhe Ligën e Kampioneve, duke kontribuar me pesë gola e dy asistime në përgjithësi. Kartoni i tij e kap vlerën e 25 milionë eurove, ndërsa pëlqehet shumë edhe nga AC Milani e Juventusit.

Ekipi i xhudos përgatitet në Austri

Kampi Olimpik Stërvitor në Mittersill të Austrisë po mirëpret xhudistë nga e gjithë bota, përfshirë edhe ekipin nga Kosova. Nga data 7 deri më 15 janar në Mittersill po mbahet Kampi i Parë Olimpik i Stërvitor për vitin 2025 me 848 pjesëmarrës/e nga 44 shtete. Nën udhëheqjen e kryemjeshtrit Driton Kuka dhe trajnerëve Majlinda Kelmendi dhe Fatos Tabaku pjesëmarrës/e nga Kosova janë: Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Laura Fazliu, Flaka Loxha, Erza Muminoviq, Sidorela Dodaj, Laurine Gashi, Enise Zijade, Akil Gjakova, Dardan Cena, Muhamedin Veseli, Anes Veseli, Blin Kuka, Andi Reshitaj, Furkan Kelmendi, Joni Kuka. Ekipi i xhudos nga Kosova merr pjesë rregullisht në kampin Mittersill në Austri, nga ku edhe synon përgatitjet për një tjetër vit të suksesshëm në arenën ndërkombëtare.

Leclerc: Mezi pres të punoj me Hamiltonin

Londër, 9 janar - Lewis Hamiltoni e festoi 40-vjetorin e lindjes si një pilot i Ferrarit, makinë me të cilën do të garojë këtë sezon në Formula 1. Ai synon ta shkruajë historinë e këtij sporti, për ta fituar titullin e tetë kampion. Hamiltoni mori mjaft urime

për ditëlindjen e mes tyre edhe Charles Leclerc, që duke folur për britanikun, ka thënë: "Së pari i uroj ditëlindjen dhe mezi pres të punoj me të. Do të jetë një përvojë emocionuese". "Ka për të qenë një sezon interesant dhe mezi pres të shoh se si do të jetë

makina e këtij viti. Ardhja e Lewisit është një stimul më shumë si për mua ashtu edhe për skuadrën", u shpreh Leclerc. Leclerc mbërriti te Ferrari në vitin 2019 përkrah katër herë kampionit botëror Sebastian Vettel. Tashmë në krah do të

jetë një tjetër kampion bote, ndaj për monogaskun nuk është një risi të punojë me pilotë të tillë. "Nga kampionët ke se çfarë mëson, por edhe nga Sainz kam mësuar shumë. Konkurrenca do të jetë e madhe, ndaj duhet kujdes dhe qetësi. Ky mund të jetë një vit i



mbarë për Ferrarin", ka deklaruar monegasku.

Flick: Të lumtur për fitoren dhe për rikthimin e dyshes Olmo - Victor

BARCELONË, 9 JANAR - Pas një periudhe të komplikuar, Barcelona u rikthye më në fund të buzëqeshë. Mbrëmë këtij klubi i arritën dy lajme të mira: riintegrimi në skuadër i dyshes Dani Olmo e Pau Victor dhe fitorja në gjysmëfinale të Superkupës së Spanjës ndaj Athletic Bilbaos me rezultat 2-0. Dhe këto dy gëzime ia kanë rikthyer buzëqeshjen dhe lumturinë edhe trajnerit Hansi Flick, i cili foli në konferencë për shtyp pas lojës. "Jam mjaft i kënaqur, për skuadrën dhe për klubin, që është mjaft i lumtur me vendimin", ka deklaruar trajneri gjerman pasi iu rikthyen në dispozicion dy lojtarët, të cilët kishin mbetur jashtë listës pasi nuk ishin të regjistruar nga La Liga dhe nga Federata Spanjolle e Futbollit. "Klubi është i lumtur. Për ne ka qenë një sinjal i mirë para ndeshjes. Dëshironim ta demonstronim se jemi një skuadër", shtoi ish-trajneri i Bayern Munichut, i cili foli më pas edhe për momentin e



Barçës. "E bëmë një nisje të shkëlqyeshme, por e kemi një skuadër të re dhe duhet të mësojmë shumë gjëra. Sidoqoftë, kjo është mënyra e jonë e të luajturit. Kemi luajtur mjaft mirë kundër Athleticos dhe nuk ishte mënyra më e mirë për ta mbyllur vitin. Kemi bërë mirë edhe kundër Barbastro dhe sot kundër Athletic Bilbaos, duke e mbajtur portën të paprekur", ka nënvizuar Flick. "E kemi një

skuadër të re dhe mund të mësojmë shumë gjëra. Por, këta djelmossa dinë se si të luajnë dhe se si ta shijojnë futbollin. Ky është rrugëtimi që duam ta demonstrojmë në ndeshjet e ardhshme", ka përfunduar trajneri gjerman. Barça do ta kërkojë trofeun e parë sezonal pas pak ditësh, ndërsa në finale do ta presë fituesin e duelit të mes Real Madridit dhe Mallorcës së Vedat Muriqit.

Clevelandi fiton duelin e kryesuesve në NBA

CLEVELAND, 9 JANAR - Clevelandi fitoi me rezultat 129-122 ndaj Oklahomas duelin e dy skuadrave kryesues të dy konferencave, duke konsoliduar pozitat në krye të renditjes në NBA. Të dyja ekipet zhvilluan një ndeshje me rivalitet, ku për miqtë u dallua Alexander Shai me 31 pikë, por që s'mjaftuan. Për Cavaliersin ishte



kolektiviteti arma fituese, me shtatë lojtarë që realizuan mbi 10 pikë (43 pikë nga lojtarët e stolit). Allen me 25 pikë e Mobley me 21 pikë ishin dy shënuesit më të mirë të kësaj sfide. Pa probleme fiton Milwaukee, që mundi me

rezultat 121-105 San Antonio. Dyshja Lillard-Giannis realizoi 51 pikë së bashku. Fiton edhe skuadra e Denverit, 126-103 ndaj clippersave, takim ku të gjithë titullarët e ekipit vendës shënuan mbi 10 pikë.

REZULTATET

Cleveland - Oklahoma	129-122
Indiana - Chicago	129-113
Philadelphia - Washington	109-103
Brooklyn - Detroit	98-113
New York - Toronto	118-98
New Orleans - Portland	100-119
Denver - Clippers	126-103
Milwaukee - San Antonio	121-105

SHKURT

Lazio heq dorë nga transferimi i Ismajlit

Një nga skuadrat që synonte mbrojtësin e kombëtares shqiptare Ardian Ismajli në merkaton e janarit ishte edhe Lazio por, sipas lajmeve të fundit nga mediet italiane, duket se klubi bardhekaltër ka hequr dorë nga blerja e 28-vjeçarit. Sipas "Il Messaggero", Lazio është tërhequr nga blerja e Ardian Ismajlit në këtë sesion të merkatos. Kishte një interesim serioz për mbrojtësin e Empolit gjatë javëve të fundit, por Ismajli nuk mund të regjistrohet nëse Lazio nuk bën shiti për shkak të rregullores. Kjo lëvizje mund të jetë e përkohshme, të paktën deri në verën e ardhshme. Lojtari do ta përfundojë kontratën me Empolin në fund të sezonit dhe mund të përfaqësojë një mundësi joshëse për një transferim me parametër zero në muajt e ardhshëm.

Potter emërohet trajner i ri i West Hamit

West Ham Unitedi ka ndryshuar trajnerin pas rezultateve të dobëta. Drejtuesit e West Ham Unitedit e shkarkuan trajnerin spanjoll Julen Lopetegui, kurse në krye të skuadrës e kanë emëruar Graham Potter. Potteri e ka drejtuar Brightonin dhe Chelsea, kurse me West Hamin ka nënshkruar një kontratë për dy vjet e gjysmë. "West Ham Unitedi është i kënaqur ta mirëpresë Graham Potter si trajnerin e ri të klubit. 49-vjeçari i bashkohet Hammersit me një kontratë dyvjeçare e gjysmë", thuhet në njoftimin e West Hamit. Në anën tjetër, pas nënshkrimit të kontratës lumturi shprehu edhe trajneri anglez. "Jam i lumtur që jam këtu. Ishte e rëndësishme për mua të prisja derisa të shfaqej një punë që e ndieja se më përshtatej, dhe po aq i përshtatet edhe klubit ku do të bashkohem. Kjo është ndjenja që kam me West Ham", ka thënë Potter. West Hami është vetëm në vendin e 14-t në tabelë me 23 pikë të fituara, shtatë më shumë se zona e rënies.

Uzuni refuzon të stërvitet, kërkon largimin nga Granada

Myrto Uzuni refuzon të stërvitet te Granada në Spanjë. Sulmuesi i Kombëtares kërkon të largohet që në merkaton e dimrit. Kjo situatë vjen në një kohë kur beratasit është i shumëkërkuar në merkato dhe një ofertë nga FC Austin në MLS (ShBA) duket se ka tunduar 29-vjeçarin. "Kur u kthyem nga pushimet ai erdhi dhe tha se nuk e shihje veten në gjendje të stërvitej dhe nëse nuk stërvitet nuk ka rëndësi. Ai vazhdon me atë pozicion që nuk dëshiron të stërvitet me skuadrën, nuk mund të detyroj askënd të stërvitet dhe nëse nuk e bëjnë, nuk e llogaris", ka thënë Fran Escriba, trajneri i Granadas. Uzuni ka kontratë me Granadan deri në verën e 2026 dhe këtë sezon ka shënuar 14 gola dhe dhuruar një asist në 18 ndeshje. Këto shifra e kanë kthyer Uzunin në lojtarin më të mirë të Granadas dhe sulmuesi theu edhe rekorde duke u bërë golashënuesi më i mirë i klubit në histori. Vlera e kartonit të Uzunit është 5 milionë euro, ndërkohë që Granada që e bleu për 4 milionë euro në janarin e 2022-s nga Ferencvaros në Hungari.

Williams: Turp që luajmë në Arabi Saudite, por futbollit është i tillë

Lojtari i Athletic Bilbaos, Inaki Williams, kritikoi vendimin e Federatës Spanjolle të Futbollit për të luajtur Superkupën e Spanjës në Arabinë

Saudite. Pas humbjes në gjysmëfinale ndaj Barcelonës (2-0), sulmuesi i skuadrës baske u ankua se ky turne u luajti larg tifozëve. "Për ne,

edhe pse kishim pak tifozë, ndeshja u luajti jashtë. Është turp sepse është një ndeshje shumë tërheqëse dhe po të ishte luajtur më afër, stadiumi

do të ishte mbushur me shumë tifozë tanë. Është turp pasi duhet të udhëtojmë qindra kilometra nga njerëzit tanë, nga familjet tona.

Nuk ka kuptim të luaj në Arabinë Saudite, por futbollit është i tillë tani. Është turp, është turp dhe trishtim për mua", ka thënë Williams.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejta


RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ferdi Krasnici shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Ashim Fazlijo shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Benjamin Bilalli shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfm "Sezair Suroi" Bellobrad.

- Lulzim Selimi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Besnik Sula shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Xhyka Xhemajlaj shpall të pavlefshme letërnjoftimin e lëshuar nga Republika e Kosovës.

- Ensar Mziu shpall te pavlefshme diplomën e shmlm "Dr. Xheladin Deda".

- Arjeta Asllani shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Migjeni".

- Luigj Bekteshi shpall te pavlefshme diplomën e SHMLE "Hasan Prishtina".

- Deli Shala shpall te pavlefshme diplomën e SHMLE "Hasan Prishtina".

- Haxhi Laha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hajdar Dushi".

- Valon Kalludra nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Liridon Pnishi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Pjetër Bogdani".

- Arianit Narkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore shmu "Luigj Gurakuqi" Korenicë.

Pashk Nikmengaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore shmu "Luigj Gurakuqi" Korenicë.

Flamur Knushi B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811147976.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

